

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Kishte dalë me leje nga burgu, Alket Rizai përfshihet në një konflikt me armë zjarri në Greqi
ADRESA	https://a2news.com/shqiperia/kronike/kishte-dale-me-leje-nga-burgu-alket-rizai-perfshihe-t-ne-nje-ko-i1184993
BURIMI	a2news.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	13 shtator 2026, 21:01:24 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	13 shtator 2026, 20:58:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	fc3affa4bda0f49429a7592538dc177a1716805c63229d8eb48540186da2d024
TEKSTI	117279c9b8ee37fe542165cde63e5bbc84c93b4b9ad55f814ab7ce2335c19b62
PAMJA	4111107a5d734ed4e2bec21c0e53b8b2784cdb671c35f1a3b271b9038dabb2bb

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	ca3e98d055b2cb95418a48ab0865cb52c934633fac751aa5896e2c652bf77d7a
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	5a17c12c14e78c5a4225635ca4dd5bf0de00406a8b7800bc862a616c14968175
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet, në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/ca3e98d055b2cb95418a48ab0865cb52c934633fac751aa5896e2c652bf77d7a>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Kishte dalë me leje nga burgu, Alket Rizai përfshihet në një konflikt me armë zjarri në Greqi



Nga A2 CNN

13 Shtator 2026, 22:58 | Kronikë



Alket Rizai dyshohet se është përfshirë në një konflikt me armë zjarri në Greqi.

Policia po heton incidentin e ndodhur në Anavyssos të Greqisë, jashtë një lokali të njohur, në orët e para të së dielës.

Kamerat e sigurisë kanë zbuluar se personi i përfshirë në të shtënat me armë zjarri, të cilat shkaktuan plagosjen e dy punonjësve të lokalit, dyshohet se ishte Alket Rizai.

Ai ndodhej jashtë burgut pasi kishte marrë leje. Policia mori një telefonatë rreth orës 05:15 për të shtëna me armë në një lokal plazhi, në Avenue Athina-Sounio.

Oficerët e policisë që mbërritën në vendngjarje nuk i gjetën personat e përfshirë, por gjetën dy gëzhoja dhe gjak. Pak më vonë, në Qendrën Shëndetësore Kallivia u paraqitën dy të plagosur. Bëhet fjalë për një grek 20-vjeçar, i cili u plagos nga një copë xhami, dhe një pakistanez 41-vjeçar, i cili mori një plumb në pulpë, shkruan A2.

Sipas informacioneve, dy të plagosurit dhanë versione të ndryshme të incidentit. Nga hetimi i Policisë dhe analiza e pamjeve filmike, të cilat po shqyrtohen në detaje, filloi të formohej kronologjia e sherrit.

Fillimisht, sipas mediave greke, Rizai ishte në lokal me grupin e tij. Kur bari i plazhit e fiku muzikën për shkak të orës së vonë, ai u largua me personat që e shoqëronin. Megjithatë, pak më vonë, ai dhe grupi i tij dyshohet se e ngritën muzikën në makinë. Pronari i dyqanit doli për t'i qortuar dhe pasoi një debat i ashpër.

Në këtë pikë, Alket Rizai dyshohet se ka nxjerrë armën. Po hetohet nëse ai ka qëlluar në ajër, pasi ky element specifik nuk është sqaruar.

Pastaj, një burrë në anën e kundërt dyshohet se nxori një armë dhe qëlloi në drejtim të Rizait. Dy punonjësit e dyqanit u plagosën nga të shtënat.

Autoritetet tani po shqyrtojnë pamjet e kamerave, deklaratat dhe provat nga vendi i ngjarjes për të përcaktuar saktësisht se kush qëlloi, sa të shtëna u qëlluan dhe cilat ishin rolet e atyre që ishin të përfshirë në grindje.

(A2 Televizion)

A2 CNN **Livestream**

TE FUNDIT

Zhegrova spektakolar! Shënon dygolësh me Juventusin, por "Zonja e Vjetër" mposhtet nga Sassuolo

Më 16 shtator nuk gjykohe vetëm katër të akuzuar – edhe gjykata speciale do të jetë në bankën e provës

🕒 Pas lirit, ish-krerët e UÇK-së i rikthehen politikës? Përgjigjet ish-këshilltari i Thaçit

🕒 Laçi: Gjykata Speciale u krijua nga Serbia, me dorën e shqiptarëve

MË TË VIZITUARAT

"Të mos barazohet viktima me agresorin", gazetarja: Nëse ish-krerët e UÇK-së ...

Rama shpjegon "Territorialen" në Berat, Poliçani dhe Dimali të zemëruar me kr...

Kurti betohet me vëmendje të lufta: Asnjë gjykatë nuk mund ta njollojë UÇK-në...

LIVE UPDATES

Mbretëria e Bashkuar paralajmëron paketë të re sanksionesh ndaj Rusisë

LIVE | Gjithçka rreth Samitit Ukrainë-Europa Juglindore

Blinken në Tiranë, vizita e Sekretarit Amerikan të Shtetit në Shqipëri

MUND TE LEXONI GJITHASHTU



Sherr me babain e ish-partneres,
plagosje me çekiq në Roskovec



Meta nuk heq dorë, kërkesë për lirim nga
burgu. GJKKO e shqyrton të hënën



Tritoli në banesën e mësuesit në
Shkodër, policia hedh dyshime mbi
motivin



Kanosi 35-vjeçarin me kallashnikov në
banesën e një gruaje, arrestohen dy të
rinj në Rogozhinë



Përplasen dy automjete me turistë në
Qishbardhë-Peshkëpi



Detaje nga shpërthimi me tritol në
Shkodër, autori i maskuar si shpërndarës
picash

Latest Videos





"Në gjyq është e gjithë UÇK-ja", Arifaj: Haga po vendos në pikëpyetje luftën për liri



"Zgjidhja e krizës nuk është përgjegjësi e PDK-së, lë të merren Kurti dhe Abdixhiku"



"Qëllimi i Kurtit dhe Hamzës është shkrirja e LDK-së"



"PDK nuk i frikësohet zgjedhjeve, do dalë e para dhe do e rikthejë Kosovën në binarë"

Shqipëria	Kosova	Rajoni & Bota	Argëtim	Sport	Speciale A2
Aktualitet	Kulturë	Balkani	Showbiz	Live Euro 2024	5 gjëra në 5 minuta
Kronikë	Sociale	Bota	Lifestyle	Futboll	A2 CNN në Izrael
Politikë	Ekonomi		Kapur në kamera	Sporte të tjera	31 Minuta
Ekonomi	Politikë		Teknologji		A2 CNN në Ukrainë
Sociale	Kronikë				Lumi i kokainës
Kulturë	Aktualitet				Ditari ndërkombëtar
Moti					Zbulo
					Imagjinatë
					Dëshmi

 Live TV

[Rreth nesh](#) [Kushtet e Privatësisë](#) [Karriera](#) [Kontakt](#)

© 2023 A2 CNN / G2 Media shpk
All Rights Reserved.

Mundësuar nga  Mediadesk

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.